


Statistikat e shkaqeve të vdekjeve, 2024

Tiranë, më 18 Qershor 2025: Gjatë vitit 2024, në Shqipëri janë regjistruar 22.102 vdekje, duke shënuar një rritje prej 3,8 %, krahasuar me vitin 2023 (21.286 vdekje).

Shkaqet e vdekjeve në vitin 2024:

- 97,0 % e vdekjeve kanë ndodhur si pasojë e shkaqeve natyrale, duke shënuar një rritje prej 0,4 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2023;
- 1,9 % si pasojë e aksidenteve, duke shënuar një ulje prej 0,5 pikë përqindje;
- 0,2 % nga vrasjet, në të njëjtin nivel me vitin 2023;
- 0,9 % si pasojë e vetëvrasjeve, krahasuar me 0,8 % në vitin 2023.

Fig.1 Shkaqet e vdekjeve sipas grupsëmundjeve kryesore, 2024 (në %)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Vdekshmëria foshnjore

- Janë regjistruar 110 vdekje foshnjore në vitin 2024, nga 144 në vitin 2023;
- Norma e vdekshmërisë foshnjore ishte 4,7 për 1.000 lindje të gjalla në 2024, nga 6,1 për 1.000 në vitin 2023.

Për publikim: 18 Qershor 2025

Vdekshmëria sipas grup-sëmundjeve

- Sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut përbënin 52,9 % të totalit të vdekjeve në 2024, nga 51,7 % në vitin 2023. Brenda këtij grupi:
 - Sëmundjet kronike të zemrës: 39,1 %;
 - Sëmundjet ishemike të zemrës: 23,2 %;
 - Sëmundjet e enëve të trurit: 20,6 %.
- “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” zënë vendin e dytë të vdekjeve me 21,5%. Brenda këtij grupi, vdekjet nga pleqëria përbëjnë 70,7 %.
- Grupi “Tumoret” renditet në vend të tretë. Brenda këtij grupi:
 - Tumoret malinje të aparatit të tretjes: 34,6 %;
 - Tumoret malinje të aparatit të frymëmarrjes: 23,9 %;
 - Tumoret malinje të organeve urogjenitale: 15,1 %.

Vdekshmëria sipas gjinisë

- Sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut janë shkaku kryesor i vdekjeve për të dyja gjinitë;
- Simptomat dhe sëmundjet e papërcaktuara mirë janë më të shpeshta te femrat;
- Tumoret shkaktojnë më shumë vdekje te meshkujt.

Vdekshmëria sipas moshës

- Për grupmoshën 0-19 vjeç, dominon grupi “Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes” me 30,8 %, i ndjekur nga sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut me 26,2 %;
- Për grupmoshën 20-44 vjeç, dëmtimet traumatike dhe helmimet përbëjnë 28,0 %, ndërsa sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut zënë 32,7 %.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT:
[Statistikat e shkaqeve të vdekjeve, 2024](#)

Metodologjia

Të dhënat e shkaqeve të vdekjes

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave bazë demografike dhe shkakut të vdekjeve. Këto të dhëna bazohen mbi informacionin e marrë nga “skedat e vdekjeve” të plotësuar nga mjeku. Më pas, të dhënat pastrohen dhe përpunohen duke analizuar një sërë variablash si: përshkrimin me fjalë të sëmundjes, moshën dhe gjininë e personit, si dhe bëhet kodifikimi i shkakut sipas klasifikimit ndërkombëtar ICD -9.

Klasifikimi Ndërkombëtar "ICD-9" është klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve, i cili bën grupimin në mënyrë të koduar të 17 grupeve kryesore të sëmundjeve. Kodimi për shkaqet e vdekjeve bëhet nga mjeku dhe përbën burimin më të plotë zyrtar statistikor të sëmundjeve që janë shkak i vdekjes.

Koncepte:

Shkaku i vdekjes është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (përkrahjet në certifikatën e vdekjes).

Vdekja nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha funksioneve vitale dhe pamundësinë e reanimimit në çdo kohë pas një lindjeje të gjallë. Ky përkufizim nuk përfshin vdekjen fetale.

Shkalla e vdekshmërisë foshnjore tregon raportin e numrit të vdekjeve për fëmijët nën moshën 1 vjeç gjatë vitit me numrin e lindjeve të gjalla të atij viti, i shprehur për 1.000 lindje të gjalla.

Vdekje aksidentale janë vdekjet të shkaktuara nga shkaqe të jashtme dhe përfshijnë aksidente të qarkullimit rrugor, aksidente të transportit ujor, aksidente hekurudhore, aksidente në punë, aksidente nga zjarri, rënie, rrëzime-aksidentale, aksidente nga veprues fizik të natyrshëm ose faktorë të mjedisit dhe aksidente të tjera.

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.